

2.1 KËRKESAT E SISTEMIT

Një nga karakteristikat e programit COBISS3 është modeli i ndërtuar në tri nivele:

- ndërfaqja e përdoruesit (në klient)
- logjika e biznesit (në server)
- baza e të dhënave (në server)

Ky model siguron fleksibilitet më të madh të programit, varësi më të vogël nga pajisjet elektronike dhe sistemet operative si dhe mirëmbajtje më të lehtë. Gjithashtu ofron edhe mundësi të ndryshme të instalimit të programit COBISS3 në bibliotekë.

1. *Serveri në IZUM*

Biblioteka mund të përdor serverin e IZUM-it, në të cilin është instaluar edhe programi COBISS3. Në këtë rast, në kompjuterët e saj (klientët), të cilët kanë qasje në server, duhet të instaloj ndërfaqen e përdoruesit dhe programin Java.

Programi COBISS3 funksionon në mjediset Windows dhe Linux.

2. *Serveri në bibliotekë*

Në kompjuterin e veçantë në bibliotekë (me sistemin e instaluar operativ Windows) duhet të instalohet serveri i aplikacionit COBISS3 dhe programet shtesë (bazën e të dhënave Oracle, Java...). Biblioteka duhet t'i mundësoj IZUM-it qasje të përhershme në këtë kompjuter përmes emrit të përdoruesit *ADMIZUM*.